



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 10 shtator 2019, në mbledhjen e XV-të (pesëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10:35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu – Podvorica, Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Bashkim Sylja, ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Ardjan Emiri zyrtar i Drejtorisë së Arsimit, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare e Kosovës, Bekim Karaxhija përfaqësues nga OSBE, Tunde Molnar Bokros dhe Tomas Lengyel përfaqësues të KFOR – LMT, Skender Shatri përfaqësues i OSBE-së, Xhavit Fejza dhe Nevzat Qorrolli nga UNMIK.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi rreth pikave të rendit të ditës shtoi, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 02.08.2019

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 02 korrik 2019.

2. Përgatitjet e nxënësve të Komunitetit jo shumicë për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/2020, në Komunën e Podujevës

znj. Albina Avdiu, theksoi, vlen të theksohet se në bazë të disa statistikave që unë posedoj, në SHFMU “Isa Boletini” vijojnë mësimin 12 nxënës të komunitetit jo shumicë, në SHFMU “DR Ibrahim Rugova” gjithsej janë 64 nxënës të komunitetit jo shumicë dhe në kuadër të kësaj shkolle funksionon edhe Qendra për mësim shtesë ku vijojnë mësimet shtesë 52 nxënës prej tyre 2 student, pastaj në SHFMU “Naim Frashëri” vijojnë mësimet 56 nxënës të komunitetit jo shumicë, kurse në SHFMU “Shaban Shala” janë 8 nxënës të komunitetit jo shumicë që vijojnë mësimet.

Në shkollat fillore janë pajisur me tekste shkollore të gjithë nxënësit, ndërsa ata të shkollave të mesme ende jo dhe tani për tani kanë mungesë të teksteve shkollore. Ajo që po ashtu vlen të theksohet është se nxënësit e komunitetit jo shumicë kanë kërkuar që të pajisen edhe me materiale tjera shkollore siç janë fletore, dhe të tjera. Pra kjo ishte një informatë e shkurtër rreth procesit të mësimi konkretisht nxënësve të Komunitetit jo shumicë që vijojnë mësimet në shkollat e Komunës së Podujevës, për më shumë e hapi debatin.

z.Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, lidhur me këtë temë ne çdo herë kemi diskutuar dhe e kemi trajtuar për çdo vite pothuajse sepse kemi të bëjmë me proces mësimor si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të të rinjve. Sa i përket teksteve shkollore që Komuna ndihmon nxënësit e komunitetit jo shumicë, konsideroj se mund t'i përshpejtojmë procedurat dhe sa më shpejt që është e mundur t'ju shpërndajmë atyre nxënësve që janë në nevojë ekonomike sociale, mirëpo për detaje tjera këtu kam ftuar të jetë prezent edhe zyrtari i Drejtorisë së Arsimit z.Ardjan Emini i cili është më në rrjedha dhe mund të na njoftoj më gjerësisht. Vlen të theksohet që si Komunë vazhdimisht kemi ndihmuar nxënësit e komunitetit jo shumicë qoftë me tekste shkollore ata të shkollave të mesme sepse për mësim fillor tekstet jepen nga Ministria, pastaj kemi interferuar edhe sa i përket regjistrimit të nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla me qëllim që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë procesit shkollos, por që të gjithë ata që dëshirojnë të vijojnë mësimin, t'iu mundësohet regjistrimi në shkollat e Komunës së Podujevës, pastaj kemi ndihmuar edhe bursa dhe ndihma tjera të nevojshme, edhe pse jemi në dijeni shkollimi i ulët është obligative për nxënësit, mirëpo duke parë rrethanat është dashur që gjithëherë t'i stimulojmë për regjistrim në shkolla, mandej edhe ata nxënës që kanë përfunduar shkollimin e mesëm dhe kanë qenë të interesuar të vijojnë studimet nëpërmjet formave të ndryshme i kemi ndihmuar, gjë për të cilën si Komunë kemi marrë mirënjohje dhe jemi vlerësuar për këtë nga Organizata të ndryshme qoftë vendore qoftë ndërkombëtare, e që mund të them se rrallë mund të ketë ndonjë Komunë që bënë këtë stimulim dhe këtë motivim të nxënësve për vijimin përkatësisht vazhdimin e shkollimit, e që jemi të përgatitur ta vazhdojmë edhe në të ardhmen, qoftë për nxënësit e komunitetit jo shumicë qoftë ata të komunitetit shumicë që janë me gjendje të rëndë ekonomike sociale.

z.Ardjan Emini, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, theksoi, fillimisht dëshiroj t'ju siguroj që ne si Komunë përkatësisht si Drejtori e Arsimit mbetemi të përkushtuar për ofrimin e kushteve sa më të mira për nxënësit në përgjithësi me qëllim të arritjeve sa më të madhe të sukseseve dhe kryqes sa më të madhe të nxënësve në sistemin e rregullt të arsimor. Sikurse viteve të kaluara Komuna e Podujevës është një ndër Komunitatet e pakta që i kushton rëndësi shumë të veçantë nxënësve të komunitetit jo shumicë, si në ofrimin e bursave, teksteve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme ngase deri në klasën e nëntë tekstet shkollore jepen nga Ministria. Sigurisht jeni në dijeni se ka disa vite që Komuna e Podujevës siguron tekste falas për nxënësit e shkollave të mesme të komunitetit jo shumicë, pa përjashtuar edhe nxënës të komunitetit shumicë të cilët janë me gjendje të rëndë ekonomike sociale. Ajo çka vlen të adresohet ndoshta si vërejtje është se nga viti i kaluar një numër i teksteve shkollore ka mbetur pa u marrë nga ana e një numri të nxënësve të komunitetit jo shumicë edhe përkundër thirrjeve dhe ftesave që ju kemi bërë për të ardhur në Drejtori që ti marrin tekstet shkollore, kjo ndoshta për shkak të mos informimit nga ana e përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë kurse ne si Drejtori nuk kemi pasë kontakte të drejtpërdrejta me ata nxënës por vetëm me përfaqësues të komuniteteve. Gjithashtu edhe bursat ju kemi ndarë me kohë të gjithë përfituesve me qëllim që të jenë më të përgatitur qysh në fillim të procesit mësimor. Pastaj ne si Komunë kemi bashkëpunim të shkëlqyer me komunitetet jo shumicë sa i përket procesit arsimor, ofrimit të shërbimeve, ofrimit të kushteve etj, gjë kjo e cila ka bërë që edhe Organizatat të ndryshme qoftë vendore qoftë ndërkombëtare të ofrohen me ndihma të ndryshme për nxënësit e

komuniteteve jo shumicë të Komunës së Podujevës ku kemi Qendrën për mësim shtesë që është në Shkollën “DR Ibrahim Rugova”, mandej në bashkëpunim me Organizatat GIZ dhe Ter Be Home, kemi dy klasë mësimore për nxënësit e komuniteteve jo shumicë, njëra në Shkollën “Xheladin Rekaliu” tjetra në atë “Enver Maloku”. Përveç kësaj, Komuna e Podujevës është ndër 4 Komunitat e vetme në Kosovë që është Komunë e Ekselencës, gjithnjë falë përkushtimit dhe bashkëpunimit me komunitetet jo shumicë. Nga muaji shtator 2018 ne si Drejtori kemi punuar intenzivisht së bashku me GIZ – Gjerman, për hartimin e planit për inkuadrimin dhe nxitjen sa më të madhe të komuniteteve për mësimnxënie, e që në muajin qershor të këtij viti kemi përgatitur një plan të veprimit e që shumë shpejt do të dalim me pikat kryesore që janë edhe pika shtyllë me rëndësi për nxënësit e komunitet jo shumicë, takime ku kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësues të komunitetit jo shumicë, andaj besoj se të gjitha parakushtet janë që nxënësit e komuniteteve jo shumicë të kenë një mësim cilësor dhe mos ngecjes së tyre për shkaqe të ndryshme teknike.

z.Bashkim Sylja, theksoi, kam tri pyetje për parafolesin, 1-a keni informata për ndonjë fëmijë të komunitetit jo shumicë që nuk vijon mësimet, 2-sa është numri i nxënësve të komunitetit jo shumicë që nuk kanë marrë tekstet shkollore në vitin e kaluar, 3-a ka mundësi që Komuna t’ju dërgoj tekstet nëpër shkolla ku ata nxënës vijnë shkollimin në mënyrë që mos të mbeten mbrapa.

z.Ardjan Emini, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, theksoi, përgjigje parafolesit, tekstet shkollore janë të destinuara për ata nxënës që vijnë në mësimin e mesëm, dhe mu për këtë ne për çdo vit jemi të përkushtuar të ndihmojmë në formë të ndryshme që ata nxënës të paktën të mos mbeten analfabet, sa i përket numrit të nxënësve që nuk kanë marrë tekstet shkollore në vitin e kaluar është rreth 10 nxënës edhe pse kemi pasë takime me prindër dhe përfaqësues të komunitetit jo shumicë për këtë çështje, ndoshta edhe vdekja e përfaqësuesit që ka qenë Shaban Ahmeti ka ndikuar të krijohet një shqetësim dhe komunikimit për një kohë të caktuar. Sa i përket pyetjes lidhur me dërgimin e teksteve nga ana e Komunës nëpër shkolla, është një ide që e kemi shqyrtuar dhe nëse do të bëhej fjalë për një shkollë, nuk do të paraqiste problem, por për shkak se sigurimi i këtyre teksteve bëhet përmes prokurimit, fillimisht duhet të shkarkohen në Komunë, pastaj ne duhet të përgatitim një listë për tu shkarkuar edhe ne si Komunë, duhet të nënshkruaj secili prej atyre që merr tekstet, në të kundërtën del që ne kemi marrë tekstet dhe i kemi përdorë për interesa personale dhe nuk janë shkuar në vendin e duhur, pra kjo ka qenë faktor.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sa kemi informata në vitin e kaluar janë vonuar tekstet shkollore t’iu ndahen nxënësve në fjalë dhe ka shkuar një kohë paksa e gjatë pas fillimit të vitit shkollor që nuk janë pajisur me tekste, këtë vit ne kemi diskutuar disa herë që tekstet shkollore të sigurohen më herët në mënyrë që në fillim të vitit shkollor të jenë të pajisur me libra të gjithë nxënësit me qëllim të nxitjes së mësimin, andaj shtroj pyetje se kur pritet të furnizohen nxënësit në fjalë me tekste shkollore për këtë vit.

z.Ardjan Emini, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, theksoi, sa i përket vitit të kaluar kanë qenë disa zgjatje të procedurave të prokurimit por edhe numrit jo të saktë të nxënësve që kërkohet t’iu sigurohen ato tekste, jo për fajin e Komunës, kurse në këtë vit pritet që brenda 1 jave të nënshkruhet kontrata dhe të fillohet me shpërndarjen e tyre.

znj.Albina Avdiu, theksoi, gjithashtu dua të paraqes disa kërkesa që janë paraqitur në takime të ndryshme që kemi me nxënës të komunitetit jo shumicë. Në Qendrën për mësim shtesë në shkollën “DR Ibrahim Rugova” ka kërkesë për sigurimin e një kompjuteri Laptop për nevojat e atyre nxënësve, pastaj ka kërkesë për ngritjen e një Qendre për mësim shtesë në Shkollën “Naim Frashëri” sepse numri i atyre që vijnë shkollim në këtë shkollë është rreth 70, si dhe kërkesa tjetër e nxënësve dhe prindërve të komunitetit jo shumicë është që varësisht mundësive Komuna të

siguroj edhe materialet shtesë që janë të nevojshme për mësimnxënie si fletore, çanta etj, të ngjashme.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, konsideroj se do të ishte mirë që të formohej edhe një Qendër për mësim shtesë në njërën prej shkollave “Shaban Shala” apo “Naim Frashëri” sepse vërtetë është një numër i madh i nxënësve të komunitetit jo shumicë që vijnë shkollimin në këto dy shkolla si dhe për shkak të shmangies së rrugëtimit të atyre nxënësve që të shkojnë në Shkollën “DR Ibrahim Rugova”.

z.Ardjan Emini, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit, theksoi, përgjigje parafolëses, ne do të analizojmë një kërkesë të tillë dhe nëse vlerësojmë se është e domosdoshme dhe nëse paraqitet edhe kërkesë nga komunitetit jo shumicë sigurisht që do të ngritim një Qendër për mësim shtesë edhe në një prej këtyre dy shkollave që u përmenden, mirëpo duhet analizuar mirë sepse mund të ketë çrregullim të procesit mësimor.

z.Bashkim Syla, theksoi, rreth asaj që znj.Doruntina Hasani e tha, pajtohem me z.Ardjan Emini sepse mund të ketë çrregullime të procesit mësimor, andaj është mirë që të analizohet mirë kjo gjë.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, fillimisht dëshiroj të falënderojmë Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim për ndihmën dhe përkushtimin e treguar për nxënësit e komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës.

Sa i përket shpërndarjes së teksteve shkollore për nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe atyre të komunitetit shumicë që janë me gjendje jo të mirë ekonomike, do të ishte mirë të kërkohej nga drejtorët e shkollave t’i informojnë ata nxënës dhe të kërkojnë nga ata që të lajmërohen në, Drejtorinë e Arsimit për të marrë tekstet shkollore në mënyrë që të jenë në hap me procesin mësimorë.

znj.Albina Avdiu, theksoi, meqë diskutimet rreth kësaj teme përfunduan dhe pati efekt kjo temë sepse u sqarua në shumë çështje, meta borgj të paraqes edhe një informatë, përkatësisht fjala është për 4 nxënës të komunitetit jo shumicë të cilët e kanë ndërprerë mësimin, arsyen në deje nuk i di por vetëm jam e informuar për këtë andaj edhe deshta të paraqes para juve si informatë. Kërkoj që sugjerimet e dhëna të adresohen nga secili prej nesh.

3. Të ndryshme

Pas diskutimeve mes anëtarëve të Komitetit, si përfundim mbetet që vizita e radhës e planifikuar në fshatrat Orllan dhe Batllavë, të realizohet më 19 shtator 2019, nga ora 10:00 si nisje nga hapësirat (auto parkingu) i Komunës.

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05’

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-016/01-0073209/19
Podujevë,
10 shtator 2019

Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu
